

REZYME PËRFUNDIMTARE

NGA RAPORTI I MONITORIMIT TË PUNËS
SË AVOKATIT TË POPULLIT ME FOKUS TË
PARANDALIMIT DHE MBROJTJES NGA
DISKRIMINIMI

(2010 - 2019)



Botues: Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara" MARGJINAT Shkup, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi

Autorë: Stojan Mishev dhe Sanja Jovanoviq-Paneva

Bashkë autore: Dragana Drndarevska

Redaktore: Manja Veliçkovska

Përkthimi: Gramoz Shabani

Lektura: Lejla Qaili

Redaktimi grafik: KOMA

Shytpi: Vinsent grafika

Tirazhi: 50

Shkup, gusht 2020

CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

351.941:342.72/.73.037(497.7)"2010/2019"(047)

351.941:316.64782(497.7)"2010/2019"(047)

MISHEV, Stojan

Rezyme përfundimtare nga raporti i monitorimit të punës së Avokatit të popullit me fokus të parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi : (2010-2019) / [Autorë Stojan Mishev and Sanja Jovanoviq-Paneva ; bashkë autore Dragana Drndarevska]. - Shkup : Koalicioni Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara MARGJINE, Rrjeti për mbrojtje nga diskriminimi, 2020. - 16 стр.; 21 см
ISBN 978-608-4803-23-2

1. Jovanoviq-Paneva, Sanja [автор] 2. Drndarevska, Dragana [автор]

а) Народен правобранител -- Дискриминација -- Спречување и заштита -- Македонија -- 2010-2019 -- Извештаи
COBISS.MK-ID 52085253



RRJETI PËR
MBROJTJE NGA
DISKRIMINIMI



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN OTVORENO
SOCIETY ШОЦИЈЕТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

Projekti "LPMD nën thjerrrë: Vëzhgimi i zbatimit të Ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi" i financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe grantistit, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

PËRMBAJTJA



04
REZYME

10
PËRFUNDIME



14
REKOMANDIME



REZYME

Mbrojtja nga diskriminimi është pjesë thelbësore nga të gjitha të drejtat e njeriut dhe e garanton të drejtën e barazisë për të gjithë. Barazia e lirive dhe të drejtave të gjithë qytetarëve është e garantuar me kushtetutë, pavarësisht nga seksi, gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, origjina kombëtare dhe sociale, bindjet politike dhe religjioze, gjendja pronësore dhe shoqërore etj. Ekzistimi i trupit të pavarur institucional siç është Avokati i Popullit, që do të përgjigjet para pushtetit ligjvënës, përfaqësuesit e të cilët janë të zgjedhurit e popullit – deputetët, dhe padyshim do të qëndrojë në anën e qytetarëve, kur të drejtat e tyre të njeriut janë shkelur nga ana e aparatit shtetëror dhe organeve tjera me autorizime publike, ka rëndësi të madhe për sistemin e përgjithshëm juridik në një shtet dhe për zbatimin praktik të parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi. Avokati i Popullit e ka për obligim t'i mbrojtë qytetarët nga diskriminimi, në mënyrë aktive t'i vëzhgoje problemet e tyre juridike lidhur me diskriminimin, të marre pjesë në zgjidhjen e tyre dhe të veprojë në mënyrë adekuate sipas parashtesave për mbrojtje nga diskriminimi, por edhe të avokoj për avancimin e kornizës ligjore për jo diskriminim dhe tejkalimin e mangësive të tij.

Duke marrë parasysh përgjegjësinë e madhe të këtij institucioni, ky Raport nga monitorimi i punës së Avokatit të Popullit me fokus të parandalimit

dhe mbrojtjes nga diskriminimi (për periudhën 2010-2019) synon të kontribuojë për avancimin e efikasitetit në punën e Avokatit të Popullit, veçanërisht në parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Dokumenti bazohet mbi pasqyrën e tipit të ndryshëm të dhënave për plotësimin e mandatit ligjor të këtij trupi në avancimin e jo diskriminimit në vend dhe veçanërisht – të problemeve individuale të grupeve të rrezikuara të qytetarëve (LGBTI, personat të cilët jetojnë me aftësi të kufizuara, njerëzit të cilët përdorin droga, të cilët jetojnë me HIV, gratë, punëtorët/et seksual/e, romët, të varfrit etj.), të cilët janë viktima të diskriminimit nga ana e organeve të ndryshme kompetente shtetërore, institucionet dhe shërbimet publike.

Gjetjet kryesore nga Raporti tregojnë mangësi nga puna e Avokatit të Popullit në më shumë fusha. Lidhur me veprimin sipas parashtesave për mbrojtje nga diskriminimi, nga periudha e monitoruar dhjetëvjeçare vërehet rritje e shumëfishtë e numrit të parashtesave të parashtruara për mbrojtje nga diskriminimi, derisa numri i lëndëve të përfunduara në nivel vjetor është më i vogël nga numri i përgjithshëm i lëndëve për të cilat ky trup ka vepruar, që është mjaft e theksuar në periudhën 2009-2014. Megjithatë, gjatë dy viteve të fundit ka rritje të shkallës së lëndëve të përfunduara sipas

parashtesave të parashtruara për mbrojtje nga diskriminimi dhe kemi pothuaj numër të barabartë të lëndëve të përfunduara për diskriminim, në raport me lëndët tjera. Megjithatë, shkalla e praktikës së mos ngritjes ose ndërprerjes së procedurave për mbrojtje nga diskriminimi është më i vogël në raport me lëndët tjera në të cilat punon Avokati i Popullit, që flet për efikasitet të madh në rastet e diskriminimit, edhe pse numri i tyre është më i vogël. Për fat të keq, në Raportet e veta vjetore Avokati i Popullit nuk ka të dhëna për shkaqet për shkak të cilave është miratuar vendim për ndërprerjen ose mos ngritjen e procedurës, që do të thotë nuk mund të fitohen informata më të sakta për raportin e lëndëve të pranuar të ndërprera dhe të refuzuara. Nuk ekzistojnë as të dhëna për numrin e lëndëve ku nuk janë dhënë rekomandime ose mendime nga ana e Avokatit të Popullit dhe arsyetime për rekomandim të dhënë në raste të caktuara.

Është e domosdoshme të përmendet se, edhe pse Avokati i Popullit i ka respektuar afatet e caktuara ligjore gjatë veprimit, rekomandimet e tija nuk janë respektuar nga ana e organeve kompetente në më pak se gjysmën e lëndëve dhe ato e kanë shkelur afatin ligjor për dorëzimin e informatave deri te Avokati i Popullit dhe për ndërmarrjen e veprimeve për tejkalimin e praktikave të caktuara diskriminuese. Janë vërejtur edhe 18 lëndë ku organet kompetente nuk kanë vepruar sipas kërkesës të këtij trupi dhe

104 lëndë për të cilat ka formulim të përgjithshëm se Avokati i Popullit i ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore, pa u saktësuar se çfarë është ndërmarrë në rastet e diskriminimit dhe nëse aty marrin pjesë edhe tetëmbëdhjetë rastet e mosveprimit nga ana e institucioneve shtetërore. Ndërsa në një pjesë të lëndëve ku nuk janë respektuar rekomandimet e Avokatit të Popullit, ky institucion nuk ka ndërmarrë veprime që ta alarmojë mosrespektimin, që do të thotë se ky institucion nuk ka praktikë adekuate për vëzhgimin e zbatimit të rekomandimeve të cilat i jep dhe nuk ndërmerr aksione plotësuese për çdo rast ku ka nevojë nga kjo. Është e dukshme mungesa e informatave për veprimet e ndërmarra dhe për tejkalimin e diskriminimit në lëndët e regjistruara mbi bazë tjetër, ndërsa në të cilat është vërejtur diskriminimi, si edhe adresimi sistemor i problemit me diskriminimin dhe mosekzistimin e metodologjisë adekuate për grumbullimin e të dhënave dhe sistem i përgjithshëm për përcjelljen e të gjitha aktiviteteve që janë nën kompetenca të Avokatit të Popullit (duke përfshirë edhe përcjelljen e veprimit të organeve shtetërore mbi rekomandimet). Është e domosdoshme që Avokati i Popullit të jetë më transparent dhe llogaridhënës përmes ndryshimit të sistemit ekzistues për grumbullimin e të dhënave, të cilat do të jenë publike në raport me bazën dhe fushën e diskriminimit, gjininë, moshën ,përkatësinë etnike, edukimin, statusin e punës dhe vendbanimin e personave të cilët kanë qenë

të diskriminuar, të dhënat për rekomandimet e shqiptuara dhe veprimin mbi ato.

Është e pashmangshme të përmendet se krahas asaj që Avokati i Popullit edhe vetë e konstaton nevojën për ngritjen e vetëdijes publike të qytetarëve si kyçe për mbrojtjen nga diskriminimi, nga viti 2016, kur këtij trupi i jepet kompetenca për promovimin e parimit të mos diskriminimit, nuk ka rritje drastike të aktiviteteve të orientuara drejt ngritjes së vetëdijes publike dhe për promovimin e të drejtave të njeriut nga më parë. Më shpesh trupi vepron në këtë drejtim përmes bashkëpunimit me organizatat qytetare kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në fushatat e tyre, dhe atë zakonisht në formë të mbështetjes, e jo në formë të aktiviteteve të pavarura për ngritjen e vetëdijes publike. Përvojat e organizatave qytetare tregojnë qartë se Avokati i Popullit nuk ndërmerr aktivitete të mjaftueshme dhe nuk është i dukshëm sa duhet në opinion, bile edhe për shoqatat të cilët e monitorojnë punën e tij.

Avokati i Popullit është caktuar për Mekanizëm parandalues kombëtar që nga viti 2008, me Ligjin për ratifikim, dhe që atëherë ekziston si trup i veçantë për parandalimin e torturës dhe lloji tjetër të veprimit të vrazhdë, jonjerëzor ose poshtërues dhe dënimi në vend. Për fat të keq, deri para vitit 2016, Avokati i Popullit nuk ka marrë pjesë në përpilimin e buxhetit të vet dhe kjo e ka kufizuar punën e tij në

fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në të vërtetë, gjetjet kanë treguar se institucioni gjatë kohë është ballafaquar edhe me mungesë të resurseve financiare, njerëzore dhe teknike për zbatimin e kompetencave ligjore në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi, që ka rezultuar me atë që Republika e Maqedonisë të mbetet pa Mekanizëm parandalues kombëtar në vitin 2015.

Me ndryshimit e Ligjit për Avokat të Popullit në vitin 2016, ky trup fitoi mundësi të dorëzojë propozim-llogari për buxhetin deri te Ministria e Financave, me të cilin e harmonizon ndarjen e Buxhetit të RMV të dedikuar për atë, të përgatisë raport në rast të mospërputhjes, të marre pjesë në përcaktimin e propozim-llogarisë në mbledhje në Qeveri dhe të disponojë pavarësisht me shfrytëzimin, ndarjen dhe qëllimin e mjeteve për punë. Krahas kësaj, 13% nga buxheti i Avokatit të Popullit në vitin 2017 ka mbetur i perealizuar, ndërsa ky është problem afatgjatë me të cilin ballafaqohet ky institucion, e që ka origjinë nga vonesa e vazhdueshme për punësim të kuadrit adekuat, që rezulton me 65 vende pune të paplotësuara në vitin 2019, që e pengon funksionimin e institucionit me kapacitet të plotë. Organizatat qytetare treguan edhe për punësimin problematik të deritanishëm në institucion të kuadrove të pamjaftueshme profesionale dhe të trajnuara. Problematik është mandati i gjatë mesatar (8 vjet, me mundësi edhe për një rizgjedhje)

të Avokatit të Popullit në vendin tonë, në raport me institucionet e këtilla në shtetet tjera.

Avokati i Popullit mesatarisht në vjet bën edhe nga një-dy hulumtime lidhur me diskriminimin, por vërehet se shumë kategori të marginalizuara dhe të rrezikuara të qytetarëve, të cilët janë të rrezik të vazhdueshëm janë lënë pas dore nga ky aktivitet ose u kushtohet më pak vëmendje. Të tilla janë: LGBTI, personat që jetojnë në varfëri, personat që jetojnë me HIV, punëtorët/et seksual/e etj. Edhe këtë e ka për obligim në përputhje me Strategjinë kombëtare për barazi dhe jo diskriminim, në periudhën 2016-2020 Avokati i Popullit nuk ka realizuar asnjë analizë për gjendjen me diskriminim mbi bazë të gjinisë dhe identitetit gjinor.

Përveç kësaj, përvojat dhe perspektivat e shoqatave të qytetarëve lidhur me punën e Avokatit të Popullit treguan se në parashtrimin e parashitesave për mbrojtje nga diskriminimi, një pjesë e madhe (8/11) e organizatave qytetare janë pjesërisht të kënaqura nga mënyra e veprimit, ndërsa një pjesë e vogël nuk janë aspak të kënaqura (3/11). Organizatat të cilat punojnë me romët dhe me grupet tjera të varfra dhe të rrezikuara të qytetarëve në përgjithësi shprehën kënaqësi të pjesshme nga bashkëpunimi i vendosur, për dallim nga organizatat të cilat punojnë me komunitetin LGBTI, punëtorët/et seksual/e, personat të cilët përdorin droga dhe gratë

viktima të dhunës, të cilët aspak nuk janë të kënaqur nga bashkëpunimi me Avokatin e Popullit. Shkaku i pakënaqësisë është pavarësia e pamjaftueshme, mosbesimi në institucionin, efikasiteti i pamjaftueshëm, mosnjohja e shkëljes të drejtave dhe diskriminimi, gjetja e arsytimit për veprimin diskriminues të institucioneve, mosrespektimi i rekomandimeve nga ana e organeve shtetërore, mospasja e avancimit thelbësor të gjendjeve dhe parashtrimi i mendimeve jocilesore dhe të paqarta deri te institucionet kryese të diskriminimit. Krahas aspekteve pozitive nga puna e Avokatit të Popullit – siç janë: respektimi i afateve ligjore, dalja në terren, zbatimi i mbikëqyrjes mbi lëndët, dorëzimi me kohë i mendimeve dhe rekomandimeve – shoqatat kanë vërejtur se edhe ky institucion ka besim të madh në përgjigjet nga institucionet pa hyrë më thellë në rastet, nuk e aplikon transferimin e barrës së provës (nuk kërkon nga organi shtetëror çfarë ka bërë diskriminimi që ta dëshmojë atë dhe vërteton se nuk ka diskriminim) dhe nuk i njeh sa duhet standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e grupeve të rrezikuara të qytetarëve. Kjo e fundit brengos më shumë, veçanërisht pasi që të gjitha organizatat qytetare mendojnë se ky trup është sensibilizuar sa duhet për punë me të gjithë personat e marginalizuara në shoqërinë tonë. Rrjedhimisht, përgatitja e pamjaftueshme e Avokatit të Popullit të punojë me grupe të caktuara të rrezikuara rezulton

me vonesën e procedurës për mbrojtjen e tyre dhe vonesën e mbrojtjes nga diskriminimi. Faktori i dytë i cili kontribuon për vonesën e procedurës është pasiviteti i Avokatit të Popullit në rastet kur organet vonohen, d.m.th. e pengojnë punën e institucionit. Në rastet e tilla Avokati i Popullit mund ta informojë drejtpërdrejt organin më të lartë, por nga ajo që u tha paraprakisht është e dukshme se kjo mundësi përdoret rrallë.

Mangësitë tjera janë: papërshtatshmëria e rekomandimeve për tejkalimin e diskriminimit të shqiptuar nga ana e Avokatit të Popullit dhe pasiviteti i tij në rastet e mosrespektimit të rekomandimeve nga ana e organeve shtetërore. Prandaj, edhe më shqetësuese është mungesa e sistemit adekuat për vëzhgimin e zbatimit të rekomandimeve dhe mendimeve të këtij institucioni nga ana e organeve kompetente shtetërore. Si rezultat i kësaj, nga të dhënat e kapshme publike nuk mund të fitohet pasqyrë e qartë për numrin e lëndëve në të cilat organet nuk kanë vepruar në pëlqim me sugjerimet e Avokatit të Popullit, si dhe për veprimet e ndërmarra vijuese nga ana e tij. Është vërtetuar edhe praktika e moskryerjes së procedurës për mbrojtje nga diskriminimi pas informimit të marrë nga organet shtetërore për ndërmarrjen e veprimeve të ardhshme, gjatë kësaj pa e ndjekur nëse me të vërtetë janë ndërmarrë veprime, pas çka është vërejtur përsëritje e diskriminimit nga ana e

organeve të njëjta shtetërore edhe mbi bazë të njëjtë. Këtu, si problem kryesor paraqiten: mosekzistimi i mekanizmit për sigurimin e zbatimit të obligueshëm të rekomandimeve dhe mendimeve nga ana e institucioneve shtetërore dhe mosekzistimi i mundësisë ligjore për sanksionimin e moszbatimit të tyre.

Lidhur me sigurimin e ndihmës dhe mbrojtjes të viktimave nga diskriminimi, Avokati i Popullit siguron këshilla juridike dhe jep udhëzim për te institucionet kompetente, por nuk ofron ndihmë dhe mbështetje më të madhe nga ajo, veçanërisht jo për personat e marginalizuar shoqëror. Gjatë kësaj, përfundimi i përgjithshëm është se Avokati i Popullit në mënyrë adekuate i ndërmerr obligimet e parapara ligjore nga aspekti formal juridik, por në praktikë mungon mbrojtja efikase e personave të cilët janë diskriminuar dhe parandalimi i rasteve të njëjta të diskriminimit në të ardhmen.

Në fund, pozitive është se Avokati i Popullit ka ngritur procedurë për vërtetimin e shkeljes të drejtës dhe për mbrojtjen nga diskriminimi në të gjitha parashtesat e parashtruara nga ana e shoqatave. Avokati i Popullit pothuaj në të gjitha parashtesat i ka informuar me kohë shoqatat për ngritjen e procedurës në afat prej 15 ditëve nga pranimi i parashtesës së tyre. Prej këtui, kur flasim për zgjatjen e procedurës, kjo ka të bëjë kryesisht me mosrespektimin e afateve ligjore nga ana e

organeve shtetërore, gjegjësisht afatin ligjor për informimin e Avokatit të Popullit. Në këtë drejtim, brengos numri i madh i procedurave mbi parashtesat e parashtruara për mbrojtjen nga diskriminimi, të cilat kanë përfunduar në afat më të gjatë prej 90 ditëve, kryesisht për shkak të shkakut të cekur. Në asnjë nga lëndët e shoqatave nuk ka informata se Avokati i Popullit ka reaguar deri te organi më i lartë për pengimin e punës së tij ose se ka miratuar afat të ri për dorëzimin e informatave. Lidhur me llojin e vendimeve, në njoftimet e Avokatit të Popullit jo gjithmonë është cekur nëse është vërtetuar ekzistimi i diskriminimit, edhe pse informon për procedurë të përfunduar dhe veprimet e ndërmarra nga ana e këtij institucioni, si dhe nga ana e organeve shtetërore të cilat janë akuzuar për diskriminim.





PËRFUNDIME

Avokati i Popullit ngrenë procedura mbi parashtesat për mbrojtje nga diskriminimi dhe kryesisht i kryen me kohë. Aspektet pozitive nga puna e Avokatit të Popullit janë ngritja e procedurave në lëndët për diskriminim, respektimi i afateve ligjore, zbatimi i mbikëqyrjes në disa raste, si dhe kryesisht respektimi i dispozitave ligjore për të vepruar rreth parashtesave.

Por, problem kryesor dhe më serioz në punën e Avokatit të Popullit është mospasja e rezultateve nga puna e tij drejt avancimit të barazisë dhe drejt parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi i qytetarëve. Prej këtui, mund të përfundohet se institucioni vetëm pjesërisht e plotëson amendamentin e tij kushtetues dhe nuk ka kapacitete të mjaftueshme t'u përgjigjet kompetencave të domosdoshme ligjore. Nëse institucioni nuk pozicionet në mënyrë adekuate që në mënyrë të vazhdueshme dhe efikase të mund t'i avancojë gjendjet me të drejtat e njeriut dhe mos diskriminimin në vend, në bashkëpunime të gjithë faktorët tjerë, nuk mund të flasim për parandalim të suksesshëm dhe efikas dhe mbrojtjen nga diskriminimi nga ana e Avokatit të Popullit.

Shkaqet për këtë gjendje janë të shumta, ndërsa e kanë origjinën nga korniza ligjore dhe institucionale, por edhe nga kapacitetet njerëzore në institucion.

Efikasiteti në tejkalimin e diskriminimit është mjaft e pamundur për shkak të mosrespektimit të afateve ligjore nga ana e organeve kompetente shtetërore dhe moszbatimi i rekomandimeve dhe mendimeve të Avokatit të Popullit. Praktika e këtillë është rezultat i karakterit juridik jo obligues të rekomandimeve dhe mendimeve të Avokatit të Popullit, nga njëra anë, por edhe nga pasiviteti që e tregon mbi moszbatimin e rekomandimeve dhe për vonesën e përgjigjeve nga institucionet, nga ana tjetër. Kjo sjell deri te vazhdimi dhe përsëritja e diskriminimit mbi grupet e rrezikuara të qytetarëve nga ana e organeve kompetente, të cilat nuk e kanë ndryshuar veprimin e tyre, si dhe deri te inkurajimi i diskriminuesit dhe krijimi i gjendjes së jo ndëshkimit të veprimit arbitrar dhe të anshëm.

Ndaj këtij problemi ndërlidhet edhe papërshtatshmëria e rekomandimeve dhe mendimeve. Edhe pse nuk janë obliguese, masat për mbrojtje nga diskriminimi që i rekomandon Avokati i Popullit duhet të jenë proporcionale, efikase dhe të kenë efekt kthyes. Shkelja e të drejtave të njeriut dhe diskriminimi janë shkelje serioze të drejtës, e kështu institucioni duhet t'i trajtojë proporcionalisht që ta avancojë efikasitetin e punës së vet dhe të etablohet si mbrojtës dhe promovues i të drejtave të qytetarit. Me dhënien e rekomandimit, Avokati i Popullit duhet të parashohë afat për zbatimin e tij, të bëjë këqyrje në

zbatim, ndërsa në rast të moszbatimit, duhet të ketë mundësi për ngritjen e procedurës për kundërvajtje. Informimi i organit më të lartë ose i Qeverisë dhe Parlamentit duhet të përdoret më shpesh, por ato nuk janë masa të mjaftueshme efikase të cilat garantojnë se rekomandimi i caktuar do të zbatohet.

Llogaridhënia dhe transparencja e institucionit janë po ashtu sfidë e rëndësishme. Edhe krahas obligimit që të mbahen të dhëna statistikore mbi bazat dhe fushat për rastet e diskriminimit, të zbatohen hulumtime dhe të ndiqen gjendjet që të mund të avancohen, Avokati i Popullit nuk e plotëson këtë obligim të tij. Bile edhe sipas gjetjeve të Avokatit të Popullit, numri i lëndëve për diskriminim është realisht më i lartë nga numri i parashtesave të parashtruara mbi këtë bazë, duke pasur parasysh se në numrin më të madh të lëndëve për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, të cilat janë regjistruar mbi baza të tjera është i dukshëm ekzistimi i diskriminimit. Edhe krahas asaj se është i vetëdijshëm për këtë problem, institucioni nuk ndërmerr masa që ta ndryshojë dhe ta avancojë metodologjinë sipas të cilës i grumbullon të dhënat. Avokati i Popullit duhet të sigurojë të dhëna adekuate dhe të sakta nga puna e tij, të mundësojë këqyrje në lëndët me mbrojtjen e të dhënave personale, të japë të dhëna të ndara për parashtesat e ndërprera dhe të refuzuara dhe shkaqet për këtë, publikisht t'i

shpalle biografite e të punësuarve dhe më rregullisht ta informojë opinionin për punën e tij përmes kumtesave, konferencave dhe evenimenteve tjera publike.

Kapacitetet e dobëta njerëzore të institucionit dalin nga problemet me pavarësinë, por edhe nga njohuritë dhe shkathtësitë të Avokatit të Popullit, zëvendësve dhe të punësuarve tjerë në institucion. Është e domosdoshme dhe parakusht për plotësimin e mandatit të këtij institucioni, në atë të punësohen kuadro profesionale, të cilat kanë përvojë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kuadro që nuk janë të afërta me asnjë parti politike. Mospasja e vullnetit politik për ndërtimin e pavarësisë dhe institucionit profesional duhet të tejkalohet me garancitë ligjore dhe të ashtuquajturit roje për pavarësi dhe kompetenca. Nevojitet që të rishqyrtohen procedurat dhe kriteret për zgjedhje të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve, që të sigurohet dhe garantohet transparencja, procedura inkluzive ku njohësit më të mirë të drejtave të njeriut do t'i fitojnë këto pozita të rëndësishme. Formulimi ligjor "jurist i diplomuar i cili ka përvojë pune mbi nëntë vjet në punë juridike dhe aktiviteti i të cilit është dëshmuar në fushën e mbrojtjes të drejtave të qytetarit dhe gëzon autoritet", le mundësi që për Avokat të Popullit të zgjidhet cilito jurist, pasi që nuk ekziston kriter objektiv, sipas të cilit mund të caktohet nëse ndonjë kandidat është i dëshmuar dhe gëzon autoritet.

Procedura për zgjedhje të Avokatit të popullit në Parlament nuk parasheh pjesëmarrje të shoqatave, mediave, sindikatave, hulumtuesve, e as obligim që të publikohen biografite personale dhe emrat e kandidat[ve të paraqitur, që le hapësirë të gjerë për kalkulime partiake në Parlament. Problem shtesë është edhe mandati i gjatë dhe kërkesa që të gjithë zëvendësit të jenë juristë të diplomuar, që njëkohësisht nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Mungesa e resurseve financiare, njerëzore dhe teknike për zbatimin e kompetencave ligjore në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi, e hap pyetjen për avancimin e pavarësisë financiare të institucionit dhe realizimin e obligimit të shtetit që të sigurojë mjete të mjaftueshme për realizimin e të gjitha kompetencave, sipas kriterëve objektive. Avokati i Popullit nuk guxon të varet nga Ministria e Financave që t'i realizojë punësimet në institucion, pasi që kjo sjell deri te pengesa e punës së tij nga ana e aparatit shtetëror.

Kompetencat e Avokatit të Popullit duhet të zgjerohen drejt mundësisë që të kyçet në procedurat gjyqësore dhe vetë të iniciojë procedura para gjykatave dhe para institucioneve tjera. Avokati i Popullit ngre procedura me iniciativën e tij, por numri i tyre është i vogël në krahasim me numrin e përgjithshëm të lëndëve. Nga të gjitha procedurat që

i ka ngritur me iniciativën e tij, numri i procedurave për jo diskriminim dhe përfaqësim të drejtë është i vogël dhe lëvizë prej një deri në dy procedura në vjet. Avokati i Popullit rregullisht duhet t'i shfrytëzojë mundësitë që të iniciojë procedura sipas detyrës zyrtare, të japë propozime për ndryshime dhe plotësime të kornizës ligjore dhe të veprojë si amicus curiae (mik i gjykatës), përkundër gjendjes së tanishme të shfrytëzimit incident të këtyre instituteve.

Bashkëpunimi i pamjaftueshëm me shoqatat e qytetarëve dhe pakënaqësia e tyre nga bashkëpunimi i tillë është edhe një sfidë e rëndësishme, edhe krahas obligimit ligjor të Avokatit të Popullit që të bashkëpunojë me ata. Aleanca me shoqatat, organizatat ndërkombëtare, sindikatat dhe të gjitha trupat tjerë për avancimin e të drejtave të njeriut është standard ndërkombëtar që ky institucion nuk e plotëson sa duhet.

Promovimi i të drejtave të njeriut dhe jo diskriminimi përmes fushatave dhe aktiviteteve edukative është edhe një anë e dobët në punën e Avokatit të Popullit. Pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve iniciohen dhe zbatohen me organizatat ndërkombëtare dhe shoqatat e vendit, që është pozitive, por institucioni duhet edhe vetë të iniciojë dhe të zbatojë aktivitete të këtilla si pjesë thelbësore nga mandati i tij. Aktivitetet e Avokatit të Popullit

duhet të zbatohen vazhdimisht, të jenë zhvillimore dhe të planifikuara, përmes përgatitjes dhe zbatimit të dokumenteve strategjike të cilat tani mungojnë.





REKOMANDIME

Nga Raporti i monitorimit të punës së Avokatit të Popullit del edhe një rekomandim për riformimin e institucionit, para së gjithash ngas aspekti i kornizës ligjore dhe institucionale, si dhe vendosjen e praktikave të reja në bazë të rolit të Avokatit të Popullit dhe standardeve ndërkombëtare për institucionet kombëtare për të drejtën e njeriut. Pas ekzistimit prej disa dekadave, institucioni ballafaqohet me mangësi serioze në sigurimin e mbrojtjes të suksesshme dhe efikase të drejtave të njeriut, mes të cilave edhe parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Rekomandime për avancimin e kornizës ligjore:

- Ministria e Drejtësisë të organizojë proces inkluziv të ndryshimeve të Ligjit për Avokatin e Popullit, ku do të pranohen rekomandimet e shoqatave të qytetarëve, organizatat ndërkombëtare dhe standardet ndërkombëtare për institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut;
- Parlamenti të miratojë ndryshime kushtetuese me të cilat do të shkurtohet mandati i Avokatit të Popullit në maksimum prej 7 deri 8 vjet, pa mundësi për rizgjedhje, si dhe të vendoset garancia kushtetuese për pavarësinë e institucionit;
- Kriteret për zgjedhje të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve rreptësisht të përcaktohen në Ligj, ndërsa të lihet mundësia që në këto funksione të zgjedhën edhe kandidatë nga profesione tjera shoqërore;
- Në këtë Ligj të parashihet procedura transparente dhe inkluzive për zgjedhje të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve, me pjesëmarrje të gjitha palëve të interesuara dhe relevante, publikimi dhe diskutimi për kandidatët e paraqitur, pjesëmarrje e drejtpërdrejtë e shoqatave në zgjedhjen dhe parashikimin e afateve për zbatimin e të gjitha pjesëve nga procedura për zgjedhje;
- Të sigurohet pavarësia financiare e institucionit përmes caktimit të buxhetit adekuat mbi kriteret objektive në përputhje me kompetencat, ndërsa me ligj të kufizohen mundësitë e Ministrisë së Financave që të intervenojë në buxhetin e propozuar nga ana e Avokatit të Popullit, vetëm në rastet e numëruara sipas kriterëve objektive;
- Të parashihet mundësia ligjore për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në rastet kur organet e aparatit shtetëror nuk veprojnë sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe/ose nuk i përgjigjen kërkesës për informata dhe/ose në mënyrë tjetër e pengojnë punën e tij;

- ▣ Të parashihet mundësia ligjore për Avokatin e Popullit që të përzihet në procedurën gjyqësore dhe vetë të iniciojë procedura gjyqësore dhe procedurat para organeve tjera; dhe
- ▣ Të parashihet obligimi ligjor për transferimin e barrës së provës në procedurën para Avokatit të Popullit për rastet e diskriminimit dhe rastet lidhur me punën.

Rekomandime për avancimin e praktikave në Avokatin e Popullit:

- ▣ Avokati i Popullit ta avancojë transparencën gjatë punësimit në institucion dhe t'i forcojë kriteret për punësim përmes vendosjes së matjeve për përvojën konkrete të punës në fushën për të cilën shpallet konkursi, si dhe të parashohë masa afirmative për punësimin e personave nga bashkësitë e marginalizuara;
- ▣ Avokati i Popullit minimum një herë në muaj ta informojë opinionin për fusha të ndryshme nga puna e tij, rregullisht të mbajë konferencë për media, konference ekspertësh dhe aktivitete të ngjashme;
- ▣ Avokati i Popullit rregullisht të reagojë publikisht në çështje lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe diskriminimin, dhe gjithmonë kur ka njohuri të ngrejë procedura me iniciativën e tij;
- ▣ Avokati i Popullit të miratojë metodologji të re për grumbullimin e të dhënave nga rastet në të cilat punon. Të dhënat nga parashtesat e diskriminimit të jenë të ndara mbi baza dhe fusha të diskriminimit, të prezantohen ndaras parashtesat për të cilat procedura është ndërprerë dhe për të cilat procedura nuk është ngritur, ndërsa raporti të përmbajë arsyetime të hollësishme për vendimet që i sjell nga puna sipas parashtesave;
- ▣ Avokati i Popullit të mundësojë këqyrje në punën sipas parashtesave me mbrojtjen e të dhënave personale;
- ▣ Avokati i Popullit të vendose politika të brendshme për barazi dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe ngacmimi më vendin e punës;

- Avokati i Popullit rregullisht, të paktën një herë në vjet, të zbatojë hulumtime në fusha të ndryshme dhe bazat e diskriminimit, dhe të paktën njëherë në vjet të realizojë fushata për barazi dhe jo diskriminim;
- Avokati i Popullit të miratojë plane strategjike dhe dokumente të ngjashme strategjike për zbatimin e aktiviteteve dhe për zhvillim të institucionit;
- Avokati i Popullit ta informojë organin më të lartë dhe Qeverinë gjithnjë kur pengohet puna e tij përmes vonesës, mosdorëzimit e informatave ose moszbatimit e rekomandimeve;
- Avokati i Popullit të miratojë politikë të brendshme për bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve dhe të caktojë kuadër adekuat të angazhuar për informim dhe bashkëpunim me shoqërinë civile;
- Avokati i Popullit të miratojë dhe të zbatojë plan për edukim dhe edukim të mëtejshëm të kuadrit të vet përmes trajnimeve të vazhdueshme në përpurthje me nevojat dhe trendët në të drejtën për të drejtat e njeriut;
- Avokati i Popullit t'i fuqizojë kapacitetet e institucionit për punë me grupet e marginalizuara të qytetarëve, siç janë LGBTI, punëtorët seksual, personat që jetojnë me HIV, personat që përdorin droga, personat me kufizime, gratë viktime të dhunës së bazuar në gjini dhe të tjera, dhe t'i sensibilizojë të punësuarit e vet për nevojat dhe për shkeljet e të drejtave të këtyre bashkësive;
- Avokati i Popullit plotësisht t'i realizojë aktivitetet për avancimin e barazisë në fusha të ndryshme, të parapara si obligime të tija në përputhje me politikat kombëtare për barazi dhe jo diskriminim;
- Avokati i Popullit rregullisht të parashtojë raporte për gjendjen me barazinë dhe jo diskriminimin deri te mekanizmat ndërkombëtar dhe regional për të drejtat e njeriut; dhe
- Avokati i Popullit të sigurojë qasje të plotë për personat me aftësi të kufizuara deri te hapësirat e tija, si dhe qasje deri te informatat që i shtyp dhe i publikon në ueb faqen e tij.

